



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Prishtinë, 16 nëntor 2022
Kodi i ZRRE-së: V_1635_2022

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Duke u bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 9, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7, Nenit 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.5, Nenit 26 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2, Nenit 46 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 dhe Nenit 48 paragrafi 1, 2 dhe 3 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Dispozitat e Nenit 16 paragrafi 1, Nenit 28 paragrafi 1 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 05/L-085);
- Dispozitat e Nenit 18 paragrafi 1 të Ligjit për Energjinë (Ligji Nr. 05/L-081);
- Dispozitat e Nenit 4, Nenit 5, Nenit 8, Nenit 9, Nenit 17 dhe Nenit 19 të Rregullës Nr. 03/2017 për vendosjen e të hyrave të lejuara maksimale të Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe Tregut (OST/OT);
- Dispozitat e Nenit 4, Nenit 5, Nenit 8, Nenit 9 dhe Nenit 16 të Rregullës Nr. 05.2017 për vendosjen e të hyrave të lejuara maksimale të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes(OSSH);
- Propozimin për Vlerat Hyrëse – Faktori i Efikasitetit, të pranuar nga KOSTT SHA me datë 27 korrik 2022; dhe
- Propozimin për Vlerat Hyrëse – Faktori i Efikasitetit, të pranuar nga KEDS Sh.A me datë 29 korrik 2022, në kuadër të Shqyrtimit të Tretë Periodik për Periudhën Rregullative 2023-2027,

në seancën e mbajtur më 16 nëntor 2022, nxori këtë:

V E N D I M

- I. **APROVOHEN** - Vlerë Hyrëse, Faktori i Efikasitetit për Operatorin e Sistemit të Transmetimit, Operatorin e Sistemit dhe Operatorin e Tregut (OST/OT) si dhe Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) për Periudhën e Tretë Rregullative (PRR3) 01 prill 2023 – 31 mars 2028, si në tabelën në vijim:

Vlerat Hyrëse- Faktori i Efikasitetit	Njësia	2023	2024	2025	2026	2027
OST/OT- KOSTT	%	1.5	1.5	1.5	1.5	1.5
OSSH- KEDS	%	1.5	1.5	1.5	1.5	1.5

Vlerat hyrëse – faktori i efikasitetit i përcaktuar për OST/OT dhe OSSH

- II. **OBLIGOHEN** - Operatori i Sistemit të Transmetimit, Operatori i Sistemit dhe Operatori i Tregut (OST/OT) si dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH-së) për zbatimin e këtij vendimi për Periudhën e Tretë Rregullative prill 2023- mars 2028.

A R S Y E T I M

- o Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE), me datë 26.05.2022 ka iniciuar Procesit e Shqyrtimit Periodik për Periudhën e Tretë Rregullative (PRR3) për të vendosur të Hyrat e Lejuara Maksimale



(në tekstin e mëtejme HLM) të të licencuarve OST/OT dhe OSSH, për periudhën 1 prill 2023 deri më 31 mars 2027.

- ZRRE ka njoftuar se në këtë proces të shqyrtimit periodik do të shqyrtoj vlerat hyrëse që do të shfrytëzohen për të përcaktuar HLM.
- ZRRE me datë 27 korrik 2022 nga Operatori i Sistemit të Transmetimit ka pranuar propozimin për Faktorin e Efikasitetit në kuadër të Shqyrtimit të Tretë Periodik për Periudhën Rregullative 2023-2027.
- ZRRE me datë 29 korrik 2022 nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes ka pranuar propozimin për Faktorin e Efikasitetit në kuadër të Shqyrtimit të Tretë Periodik për Periudhën Rregullative 2023-2027.
- ZRRE me 13 shtator 2022 ka publikuar Raportin Konsultativ - Faktori i Efikasitetit për OST/OT dhe OSSH.
- ZRRE përmes Raportit Konsultativ ka pasqyruar shkallën e pritur të përmirësimeve të eficiencës në kostot operative të OST/OT-së dhe OSSH-së, dhe faktorin ndarës të kursimeve i cili aplikohet për kursimet që tejkalojnë faktorin e eficiencës, ku ka propozuar që Faktori i Efikasitetit të jetë prej 1.5 % - 2% në vit për shpenzimet operative (OPEX) të kontrollueshme për KOSTT(OST/OT) dhe KEDS (OSSH) për PRR3.
- ZRRE ka propozuar në Raportin Konsultativ që faktori i ndarjes së kursimeve për kursimet që tejkalojnë faktorin e eficiencës për kostot mirëmbajtjes dhe riparimeve do të ndahet ndërmjet të licencuarit dhe konsumatorëve sipas faktorit 50/50. Në rast të shpenzimeve që tejkalojnë nivelin e lejuar, ato do të mbulohen nga të licencuarit në përputhje me Rregullat për të Hyrat.
- ZRRE brenda afatit konsultativ publik për Faktorin e Efikasitetit për Operatorin e Sistemit të Transmetimit, Operatorin e Sistemit dhe Operatorin e Tregut si dhe Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes, ka pranuar komente nga palët e interesit të cilat i ka prezantuar në Raportin Përfundimtar.
- ZRRE me datë 07 nëntor 2022 – ka publikuar Raportin Përfundimtar – Faktori i Efikasitetit dhe Përgjigjet ndaj komenteve, të paraqitura nga palët e interesit, në lidhje me Raportin Konsultativ.
- OST/OT ashtu edhe OSSH-ja kanë dhënë përgjigje të detajuara ndaj propozimit për Faktorin e Efikasitetit të propozuar nga ZRRE.
- OST/OT propozoi se faktori i efikasitetit duhet të vendoset në zero, duke paraqitur arsyetimet si në vijim: ZRRE do të duhej të përfshijë në mënyrë specifike pesë nga çështjet e ngritura nga KOSTT në raportin e tyre të datës 29 korrik 2022; Niveli i Faktorit të Efikasitetit është vendosur në mënyrë arbitrare në 1.5% në rishikimet e mëparshme të tarifave duke përdorur një metodologji të krijuar kryesisht për vende shumë të zhvilluara; KOSTT thekson se si kompani shtetërore nuk ka fleksibilitet të mjaftueshëm për të menaxhuar kostot, siç janë numri dhe paga e punëtorëve, negociimi i çmimeve me furnizuesit etj; dhe Kufizimet e parasë së gatshme kanë pasur ndikim në KOSTT në të kaluarën, duke rezultuar në shtyrje ose anulim të projekteve të mirëmbajtjes.



- ZRRE-ja thekson se për shkak të mungesës së llogaritjeve të standardizuara kompatible, ZRRE bazuar në të dhënat e raportuar nga të licencuarit në periudhën e realizuar paraprake vlerëson se, kompanitë operojnë në nivele të kufirit ose afër kufirit (nivelet frontier).
- ZRRE vlerëson se KOSTT është operator shtetëror, ka një nivel të pavarësisë në organizimin dhe punësimin e stafit. Për më tepër, KOSTT është gjithashtu në gjendje të rrisë efikasitetin e prokurimit duke qëndruar në vijë me udhëzimet shtetërore për praktikën e prokurimit, për të siguruar konkurrencë më të lartë nga furnizuesit.
- ZRRE vlerëson se kompanitë që operojnë në një treg monopolist, dhe veçanërisht kompanitë shtetërore, nuk janë të ekspozuara ndaj presioneve të tregjeve konkurruese. Kështu, beson se efektet e tregjeve konkurruese drejt rritjes së eficiencës duhet të simulohen përmes Faktorit të Efikasitetit.
- OSSH në komentet e saja theksoi se nuk pajtohet me propozimet e ZRRE-së për Faktorin e Efikasitetit dhe propozon që të mos zbatohet faktori i efikasitetit, duke paraqitur argumentet e saja si në vijim: OSSH-ja në periudhën e parë rregullative ka reduktuar shpenzimet operative me 11% në mënyrë kumulative, ndërsa në periudhën e dytë rregullatore me 8% të tjera duke ulur në zero mundësinë e eficiencës shtesë për vitet në vijim. Ka pasur një rritje mesatare vjetore prej 4% të klientëve aktivë, që korrespondon me përqindjen e shtimit të klientëve për kokë punëtori. OSSH-ja ka rritur eficiencën duke maksimizuar punën për kokë punëtori dhe duke minimizuar koston e shërbimit dhe inflacionit në gusht 2022 në zonën e BE-së arriti në 9.1% krahasuar me korrikun 2022 prej 8.9% që jep sinjale të rritjes së vazhdueshme të çmimeve. Gjatë përcaktimit të faktorëve të efikasitetit në shpenzimet operative, rregullatori duhet të marrë parasysh kostot aktuale, pritjet ekonomike të çmimeve në mënyrë që të sigurojë stabilitetin financiar të kompanisë për sa i përket parave të gatshme.
- ZRRE vlerëson se për shkak të mungesës së llogaritjeve kompatible të standardizuara, ZRRE bazuar në të dhënat e raportuar nga të licencuarit në periudhën e realizuar paraprake vlerëson se kompanitë operojnë në nivele të kufirit ose afër kufirit (frontier). ZRRE tashmë ka vlerësuar se OSSH-ja, operon në nivele afër kufirit dhe ka pranuar se rreth 1.6% ka reduktuar shpenzimet operative për vit për periudhën e dytë rregullatore. Kështu, faktori i efikasitetit 1.5-2% bazohet në zhvendosjen e kufirit, vlera e të cilit përcaktohet në bazë të gjykimit të ekspertëve dhe bazuar në faktorët e efikasitetit të vendosur nga rregullatorët e tjerë. Zhvendosja e kufirit supozon se edhe pse kompanitë kanë arritur kulmin e eficiencës së tyre në vitet e kaluara, për shkak të ekonomive të shkallës, inovacioneve të reja dhe teknologjive të reja, kompanitë mund të rrisin më tej eficiencën e tyre.
- ZRRE ka bërë të ditur se nuk aplikon “Sjellje Miopike” ndaj të licencuarëve kur në afat të shkurtë japin rezultate, mirëpo mund të ndikojnë jo mirë në të ardhmen (psh: reduktimi i shpenzimeve për stafin, reduktimi i zhvillimit të produktit & shërbimit të ri, blerja e materialeve të lira me cilësi më të ulët në mënyrë që kompania të mos kalojë buxhetin e saj) etj.
- ZRRE vlerëson se rritja e çmimit të mallrave dhe shërbimeve, si dhe efekti i inflacionit, trajtohen duke përshtatur OPEX-in bazë për IHÇK-në vjetore (Indekset e Harmonizuara të Çmimeve të Konsumit) dhe nuk ndikojnë në faktorin e efikasitetit (ang HICP - Harmonized Indices of Consumer




Prices). Andaj, Komentet e KEDS-it nuk kanë rezultuar në ndryshim nga propozimi fillestar i ZRRE-së.

- o Bazuar në përgjigjet e dhëna propozimi përfundimtar i ZRRE-së mbetet se duhet të zbatohet një Faktor i Efikasitetit për OPEX prej 1.5% në vit për Operatorin e Sistemit të Transmetimit, Operatorin e Tregut (OST/OT) si dhe për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) gjatë PRR3. Kjo është në pajtim shtrirjet për faktorët e efikasitetit të bazuar në vendimet rregullatore në rajon si dhe ka mbështetje në krahasimin me performancën rajonale të operatorëve të rrjetit.
 - o ZRRE në propozimin përfundimtar pas shqyrtimit edhe të komenteve ka vendosur që faktori i ndarjes së kursimeve për kursimet që tejkalojnë faktorin e efikasitetit për kostot e riparimeve dhe mirëmbajtjes do të ndahen në mes të licencuarit dhe konsumatorëve sipas faktorit 50/50. Në rast të shpenzimeve që tejkalojnë nivelin e lejuar, ato do të mbulohen nga të licencuarit në përputhje me Rregullat për të Hyrat në fuqi.
 - o Bordi i ZRRE pas vlerësimit dhe analizimit të raporteve relevante dhe pas shqyrtimit të komenteve të pranuar nga palët, duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij Vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.
- III. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së, dhe i njëjti do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të inicioj konflikt administrativ në gjykatën kompetente, tridhjetë (30) ditë, nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:


Ymer Fejzullahu, kryesues


Selman Hoti, anëtar


Izet Rushiti, anëtar


Lutfije Dervishi, anëtare


Gani Buçaj, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- (KOSTT SH.A),
- (KEDS SH.A), dhe
- Arkivit të ZRRE-së